VISP: Hua e Emergjencës për Infrastrukturën Jetike në Kosovë

Lokacioni:

Kosovë

Numri i projektit:

52167

Sektori i biznesit:

Infrastruktura komunale dhe mjedisore

Lloji i njoftimit:

Shtet

Kategoria mjedisore:

C (PMS 2019)

Data e aprovimit:

22 korrik 2020

Statusi:

Përfunduar

DPP e shpalosur:

07 maj 2020

Siç lejohet nga paragrafi 2.6 i Seksionit III të Politikave për Qasje në Informatë, shpalosja e kësaj DPP u shty në përputhje me paragrafin 1.4.4 të Direktivës për Qasje në Informatë.

Përshkrimi i Projektit

Dhënia e huas sovrane Republikës së Kosovës për dhënie të kredive ofruesve të infrastrukturës jetike (kompanitë shtetërore dhe komunale, si dhe komunave në lidhje me shërbimet e infrastrukturës) të prekur nga kriza e pandemisë Covid-19 ("Projekti"). Huaja e propozuar e likuiditetit emergjent do të vë në dispozicion financim esencial për kapitalin punues dhe stabilizim, për t'u dhënë ofruesve të infrastrukturës jetike mundësinë që të zhvillojnë reagime efektive ndaj krizës. Projekti është në kuadër të Programit të Bankës për Përkrahjen e Infrastrukturës Jetike, pjesë e Paketës së Solidaritetit 2.0.

Objektivat e projektit

i. Të sigurohet vazhdimësia e shërbimeve të infrastrukturës jetike gjatë pandemisë aktuale;

ii. Të përkrahen ofruesit e infrastrukturës jetike në mbajtjen e kapacitetit të tyre dhe kështu t'i mundësohet sektorit privat dhe ekonomisë që të rimëkëmben nga kriza;

iii. Të përkrahet përmirësimi i qeverisjes korporative të ofruesve të infrastrukturës jetike.

Ndikimi i tranzicionit

Nota ETI: 60

Ndikimi i pritshëm i tranzicionit të projektit përfshinë:

1) Rezilient:

- Përmes instrumenteve të stabilizimit për ofruesit kyç të infrastrukturës nga të cilat do të përfitojnë banorët lokalë dhe sektori privat duke siguruar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e infrastrukturës jetike gjatë dhe pas krizës COVID-19.

2) I mirë-qeverisur:

- Përkrahë miratimin dhe implementimin e draft projektligjit për ndërmarrjet publike ("NP") që i harmonizon dispozitat e tij të lidhura me qeverisjen korporative me praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Përkrahë Qeverinë e Kosovës në hartimin e politikës për pronësinë shtetërore të NP-ve.

Informatat për klientin

KOSOVA SOVRANE

Huamarrës është Republika e Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave. Përfitues janë ofruesit e infrastrukturës jetësore siç janë ndërmarrjet rajonale të ujësjellësit dhe kanalizimit, TIK, shërbimet postare, transportit hekurudhor dhe me autobusë, menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe ngrohjes qendrore.

Përmbledhje e financimit nga BERZH

30.000.000,00 €

Hua sovrane deri në 30 milionë euro.

Kostoja totale e projektit

30.000.000,00 €

Kostoja totale e parashikuar e projektit është afërsisht 30 milion euro.

Vlera e shtuar

Financimi i BERZH-it jepet në rrethana të jashtëzakonshme të krizës COVID-19. Financimi i BERZH-it e plotëson në mënyrë efektive hendekun e likuiditetit për shkak të kushteve të pafavorshme të tregut.

Përmbledhje Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar në C (PMS 2019). Projekti është kategorizuar në C, pasi përdorimi i mjeteve lidhet me sigurimin e kapitalit punues për t'i adresuar çështjet si shpenzimet e zyrës dhe pagesën e rrogave (e jo punë fizike). Nga Huamarrësi do të kërkohet që t'i përmbushë Kërkesat e Bankës për Performancë ("KP"), por meqenëse Projekti nuk pritet të ketë ndikime negative mjedisore dhe/ose sociale, nuk u identifikua nevoja për ta hartuar planin e veprimit mjedisor dhe social ("PVMS"). Kujdesi i duhur mjedisor dhe social ("KDMS") u realizua brenda, dhe konsistonte në ngritjen e pyetjeve me shkrim për MF lidhur me kushtet e punës, shëndetin dhe sigurinë, dhe procedurat e menaxhimit mjedisor. KDMS arriti në përfundimin se MF ndjek rregullativën kombëtare, por nuk ka sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë ("MShS").

Për më tepër, pasi risqet kryesore mjedisore dhe sociale ("M&S") në këtë Projekt kanë të bëjnë me aktivitetet e nën-huamarrësve të kualifikuar (përtej përdorimit të mjeteve nga Banka), një detyrë e Bashkëpunimit Teknik ("BT") pas nënshkrimit të marrëveshjes së huas drejt nën-huamarrësve të pranueshëm do të implementohet paralelisht me këtë Projekt për ta ndërtuar kapacitetet e tyre dhe për të menaxhuar risqet e tyre kryesore të M&S.

MF është në përputhje me Ligjin e Kosovës për Punën dhe punonjësit janë të lirë të anëtarësohen në organizatë punëtore. Megjithëse MF nuk ka sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ("ShSP"), aksidentet në punë dhe sëmundjet dokumentohen, siç kërkohet nga rregullativa kombëtare, dhe do të jetë vija bazë që duhet të pritet duke qenë se janë subjekte publike. Kushti që, gjatë dhënies së nën-huave, MF kërkon në marrëveshjet e huazimit të përfshihen dispozitat që kërkojnë nga nën-huamarrësit e pranueshëm ta kryejnë biznesin e tyre në përputhje me rregullativën kombëtare që lidhet me HSE dhe kushtet e punës. Vlerësimi i kënaqshëm nga Banka i pajtueshmërisë së Huamarrësit me PR-të gjatë Transhesë A është kusht paraprak i disbursimit të Transhesë B.

Faza 1 e BT-së në lidhje me Projektin është aprovuar nga Banka, duke përfshirë përcaktimin e programit të ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimin e sistemit të monitorimit, dhe do të fillojë pas nënshkrimit të marrëveshjes së huas.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi i Grantit

1. Asistencë me këshilla financiare për komunat më të mëdha për ta analizuar dhe zbutur ndikimin e COVID-19 në buxhetet dhe financat e komunave dhe kompanive komunale, dhe dhënia e shërbimeve kyçe publike.

2. Programi i ndërtimit të kapaciteteve mjedisore dhe sociale:

- Ndërtimi i kapaciteteve të nën-huamarrësve të kualifikuar për praktikat e mira ndërkombëtare ("PMN") në lidhje me çështjet M&S në sektor;
- Përkrahja e Njësisë së Monitorimit të NP-ve në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në zhvillimin dhe implementimin e një sistemi të monitorimit që i plotëson standardet e BERZH-it, për kohëzgjatjen e Projektit.

Informatat kontaktuese të kompanisë

Arianit Blakaj
blakaja@ebrd.com
+383 45 270 300

Përmbledhje e zbatimit

Kredia ka ofruar mbështetje likuiditeti për 9 NP të prekura nga kriza pandemike, e manifestuar me humbje të të hyrave, për një shumë totale kumulative prej 15 milionë euro. Kjo lehtësi u mundësoi ofruesve përkatës të shërbimeve të vazhdonin ofrimin e shërbimeve, duke luajtur një rol kritik në mirëqenien e komunitetit dhe ekonomisë, si dhe për ruajtjen e stabilitetit të tyre financiar. Për më tepër, u realizua me sukses një program për ngritjen e kapaciteteve që synonte të ndërtonte aftësinë e ndërmarrjeve për të menaxhuar rreziqet e E&S dhe për të përmirësuar raportimin e pajtueshmërisë. Ky program gjithashtu ofroi mbështetje për Njësinë e Monitorimit të NP-ve në zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi monitorimi për rreziqet E&S në përputhje me praktikat më të mira.

Përditësimi i fundit i DPP

03 prill 2024

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH:

Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH-it.

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

PMS dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e "zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor". PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në PMS.

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të

veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e Politikës së Qasjes në Informacion për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH.

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale apo dispozitat specifike për Projektin të Politikës së Qasjes në Informacion; dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjsinë ndaj Projektit për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të dërguar një kërkesë për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.